

DOKUMENT ANALITIK EX-POST

Roli i fesë në programet e deradikalizmit dhe këshillimi fetar në ambientet e burgjeve dhe të shërbimit të provës

Përmbledhje

Më 10 dhe 11 tetor 2017, Grupet e Punës për Shërbimin e Provës dhe Burgjet dhe Deradikalizmin të RAN mbajtën një takim të përbashkët në Madrid. Qëllim i takimit ishte shkëmbimi i praktikave të mira dhe përvojave për rolin e fesë në programet e deradikalizmit dhe rolin e këshillimit fetar në ambientet e burgjeve dhe të shërbimit të provës.

Në takim morën pjesë ekspertë dhe profesionistë nga shtete të ndryshme anëtare të BE-së. Pjesëmarrësit kishin përvoja me përfshirjen e fesë dhe të këshillimit fetar në programet e deradikalizmit, në burgje dhe shërbimin e provës, ose përvoja me trajtimin e fesë nga pikëpamja akademike ose e menaxhimit. Puna me fenë ose të paktën të qenit i ndërgjegjshëm për fenë në programet e deradikalizmit dhe në burgje dhe shërbimin e provës ka përfitime të mundshme. Megjithatë, puna nuk është pa pengesa dhe sfida.

Ky dokument do të përqendrohet në:

1. Grupet e synuara,
2. Praktikave të radikalizmit në shtetet anëtare,
3. Riintegrimin në shoqëri.

Ai ka për qëllim t'u japë udhëzime atyre ekspertëve të cilët punojnë me fenë apo vlerësojnë të përfshijnë fenë në këto ambiente, duke përfshirë këtu pengesat dhe vështirësitë që kjo mund të sjellë.

Hyrje

Puna me fenë në programet e deradikalizmit është një temë e ndjeshme. Një pjesë e kësaj ndjeshmërie lidhet me pyetjet mbi nivelin deri ku ndarja midis kishës dhe shtetit lejon ndërhyrjen e fesë në projektet e financuara ose të menaxhuar nga shteti. Ndjeshmëri të tjera lidhen me pyetjet mbi ndërhyrjen në bindjet fetare të dikujt ose se si duhen vlerësuar këto. Si përfundim, ndonjëherë feja thjesht nuk pranohet si shkak dhe/ose përgjigje për radikalizmin.

Burgjet kanë një traditë të gjatë me ambientet fetare dhe praninë e klerikëve, çka vijnë si rezultat i natyrshëm i lirisë fetare. Në një epokë ku është rritur ekstremizmi i nxitur nga feja, shkalla në të cilën klerikët mundën apo duhet të luajnë një rol në parandalimin, sinjalizimin ose luftën kundër radikalizmit në burgje gjithashtu mund të vihet në pikëpyetje.

Është e rëndësishme që këto dy çështje të ndryshme të trajtohen veçmas. Mënyrat në të cilat feja mund të integrohet në programet e deradikalizmit jo domosdoshmërisht mund të replikohet për këshillim fetar në burgje dhe shërbimet e provës - dhe e anasjella.

Disa prej tyre që marrin pjesë në programet e deradikalizmit, në burgje dhe në shërbimet e provës shfaqin interes për fenë. Ata mund të jenë duke kërkuar rregulla për t'i respektuar me qëllim garantimin e mirëqenies së tyre shpirtërore, ose duan të diskutojnë për fenë nga pikëpamja e tyre e radikalizuar. Kur feja është një çështje e rëndësishme në jetë, përvoja dhe studimet tregojnë se kjo mund të jetë një pikë e mirë fillese për diskutim. Prandaj, është e rëndësishme për të pasur ekspertë të cilët janë të hapur kundrejt kësaj dhe në fakt mund të flasin për çështje që lidhen me fenë.

Si përfshihet (ose jo) feja në programet e deradikalizmit/këshillimit në burgje dhe shërbimin e provës?

Brenda Bashkimit Evropian feja përdoret në programet e deradikalizmit në nivele të ndryshme. Disa e përfshijnë fenë sistematikisht, si pjesë e përpjekjeve për të demaskuar/shpërbërë indoktrinimin dhe/ose ideologjinë ekstremiste të frymëzuar nga feja për një jetë të re. Programet e tjera përshtaten me nevojat e klientëve dhe do të punojnë me fenë sipas kërkesës. Gjithashtu, feja mund të jetë një mënyrë për të hapur bisedën, veçanërisht kur është pjesë thelbësore e dikujt. Në këto raste ekziston një motivim taktik. Si përfundim, disa programe nuk punojnë fare me fenë por përqendrohen në faktorët e sjelljes ose frustrimet për shembull.

Këshillimi fetar që u ofrohet klientëve në burgje dhe shërbime të provës gjithashtu ndryshon gjerësisht. Klerikët mund të jenë anëtarë me pagesë të stafit, mund të punojnë vullnetarisht, mund të caktohen nga një komunitet fetar ose shërbimi i burgjeve dhe kështu me radhë. Autonomia e klerikëve ndryshon në varësi të formës. Siç përmendet më lart, feja është një nevojë individuale që me shumë gjasa mund të shtrihet në të gjithë popullatën e burgut. Gjatë udhëzimit të të burgosurve fetarë dhe ofrimit të ndihmës për t'u (ri)konvertuar në fenë Islame, klerikët mund të ofrojnë një nivel mbrojtjeje duke paraqitur një alternativë për versionet ekstremiste, dhe ata mund

të njoftojnë edhe personat e tjera për shenja shqetësuese. Këshillimi fetar mund të konsiderohet një mënyrë pozitive e mbështetjes së personave vulnerabël, të cilët gjithashtu targetohen nga rekrutuesit me një konotacion negativ ne-ata. Sidoqoftë, detyra kryesore e klerikëve është të kujdesen për mirëqenien fetare..

Në sistemin spanjoll të burgjeve, ndërhyrjet që synojnë ata të cilët kanë lidhje me radikalizmin e dhunshëm nuk fokusohen te feja. Logjika që qëndron pas qasjes është se radikalizmi është i lidhur me trajektoret individuale: frustrimi dhe zemërimi kundër shoqërisë janë tiparet kryesore psikologjike. Brenda kësaj panorame, dimensionimi fetar ofron një kuadër për ristrukturim të vetvetes: udhëzim dhe një tërësi të qartë normash. Ajo çfarë duhet të ndryshohet në rastin e radikalizmit është fakti se me fenë abuzohet duke e përdorur si një justifikim për krime dhe veprime të dhunshme. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur njohuritë rreth fesë Islame janë të kufizuara dhe mitet e fesë që përcillen nga grupet ekstremiste kanë një ndikim të lartë në gjendjen mendore dha fanatizmin.

Grupet e synuara

Duke pasur parasysh dallimet e përshkruara më lart lidhur me përdorimin e fesë, identifikimi i grupit të synuar për një program deradikalizmi, ose këshillim fetar në burgje dhe shërbimin e provës, është i një rëndësie të veçantë.

Në kontekstin e këtyre të fundit, grupi i synuar përfshin mundësisht të gjithë popullatën e burgut. Në fakt, çdokush ka të drejtën të praktikojë besimet e tij/saj fetare. Megjithatë, në praktikë, grupi i synuar ngushtohet tek ata persona të cilët kanë një interes në fe dhe/ose janë fetarë. Prandaj qasja varet vetëm nga nevojat e të burgosurve. Në programet e deradikalizmit, grupi i synuar përfshin në mënyrë specifike personat e radikalizuar, disa prej të cilëve besohet se janë frymëzuar nga feja.

Pika e fillësës në përdorimin e fesë duhet të diferencohet dhe të përshtatet me rrethanat, si dhe me grupin e synuar. Gjithashtu, ekspertët të cilët punojnë me të burgosurit dhe ata të cilët ndjekin programet e deradikalizmit duhet të përmbushin disa kërkesa specifike. Ata jo vetëm që duhet të jenë të trajnuar dhe me përvojë, por gjithashtu duhet të jenë të aftë të kuptojnë se si duhet t'i qasen fesë në mënyra të ndryshme sipas kontekstit.

Siç sugjerohet më lart, ka disa mbivendosje. Ndërkohë që ideologjia e frymëzuar nga feja mund të jetë një zgjidhje e lehtë për ata të cilët ndihen të dobët, për të burgosurit dhe individët në programet e deradikalizmit, dinamikat brenda shoqërisë dhe burgjeve mund ta nxisin edhe më tej këtë ndjesi.

Mendimet paragjyquese gjithashtu mund të bëjnë që stafi pa përvojë i burgut ta cilësojë çdo shenjë të fesë (terminologjinë dhe praktikën fetare, për shembull) si shenja të radikalizmit, duke ushqyer ndjesinë e vulnerabilitetit dhe të padrejtësisë. Polariteti dhe kjo mungesë e njohurive mund të sjellin si rezultat përkeqësimin e ndjenjës së vulnerabilitetit, e cila ushqen oreksin për ideologji ekstremiste. Kapelanët e trajnuar dhe punonjësit e deradikalizmit janë të pozicionuar

mirë për të identifikuar shenjat e mendimit radikal dhe ekstremist brenda një diskursi fetar. Ndhma normale fetare gjithashtu mund të ndihmojë në mënyrë të tërthortë. Në të vërtetë, puna kryesore e kapelanëve është ndihma shpirtërore: kjo mund të jetë në formën e ndihmës në grupe të hapura, si lutjet e ditës së premte. Kjo formë synon një grup të synuar shumë më të gjerë, pasi çdokush mund t'i bashkohet, ndërsa programet e deradikalizmit zbatohen në ambiente të mbyllura.

Ambientet e hapura janë veçanërisht të dobishme kur synohet një tjetër nëngrup i të burgosurve: ata të cilët nuk kanë një lidhje të atillë me fenë por kanë lidhje me të për arsye kulturore (p.sh. kremtime, vlera dhe ndjenja e përkatësisë). Një ambient i hapur grupi mundëson kontaktin me këta individë, duke u ofruar kështu një përgjigje për nevojat e tyre fetare dhe kulturore, por në të njëjtën kohë duke i bërë ata më rezistent ndaj rekrutuesve dhe mendimeve radikale.

Pjesëmarrja vullnetare është një kusht sine qua non që puna deradikalizuese të ketë sukses. Suksesi mund të përcaktohet si programi:

- për minimizimin e rrezikut të rikryerjes së veprave dhe maksimizimin e shanseve të (ri)integritimit në shoqëri;
- për parandalimin e rekrutimit, qoftë aktiv dhe pasiv;
- parandalimin e individit që të kryejë vepra që lidhen me ekstremizmin.

Përveç dëshirës së mirë, përcaktimi dhe të kuptuarit e plotë të objektivave afatshkurtër dhe afatgjatë, gjithashtu rrisin shanset për sukses. Sidoqoftë, duhet theksuar se një person fetar ka më tepër gjasa që t'i drejtohet një kleriku, ndërsa një individ i radikalizuar ka prirje që ta sfidojë dhe të jetë mosbesues ndaj një këshilluesi të fesë, pasi ai/ajo ka burimet e tij/saj të frymëzimit fetar (radikal).

Praktikat e deradikalizimit nëpër Evropë

Panoramë e përgjithshme e elementëve të përbashkët

Pa fe	Me fe
<p>Nuk ka një zgjidhje unike për të gjithë. Programet nuk duhet të jenë shumë të detajuara, por duhet të jenë mjaftueshëm fleksibël për t'u përshtatur me rrethanat individuale. Çdo hap i radhës vendoset në hapin aktual.</p> <p>Ofrohen shërbime fetare nëse është e nevojshme, por nuk zëvendësojnë rolin e specialistëve: Imamët dhe specialistët për fenë ekstremiste janë kongruentë dhe plotësues.</p> <p>Qëllimi është të rritet ndërgjegjësimi dhe, pa ndryshuar besimet, t'u mësohet individëve që të jetojnë në mënyrë pro shoqërisë: p.sh. duke punuar me ndërgjegjen emocionale për të reduktuar brengat, përmirësuar empatinë dhe hapur mendjen drejt kulturave të tjera. Feja i mbështet të gjitha këto.</p>	<p>Feja konsiderohet thelbësore nga specialistët për të fuqizuar individët e radikalizuar ndërkohë që ata kërkojnë të (ri)ndërtojnë vetëbesimin.</p> <p>Lidhur me mësimet tërësisht teologjike, lutjet e ditës së premte janë një mundësi shumë e mundshme për të mësuar rreth fesë dhe mund të jetë një mundësi për të ofruar udhëzime të tjera fetare, veçanërisht kur rekrutesit në krahun tjetër po përpigën që ta shesin DAESH si një alternativë pozitive, dhe të burgosurit apo të konvertuarit dinë pak ose aspak rreth literaturës islamike. Për shembull, pas liturgjisë ata mund të bëjnë pyetje mbi literaturën dhe teologjinë. Kjo nuk duhet të konsiderohet si një punë deradikalizuese, megjithatë mund të forcojë qëndrueshmërinë.</p>
<p>Pa vullnet nuk ka asnjë vend për ndërhyrje.</p> <p>Studimet kanë treguar se përpjekjet për të përmbysur ideologjitë fetare nuk janë metoda më efikase në punën deradikalizuese.</p> <p>Feja mund të përdoret, por ndërhyrjet duhet të trajtojnë mendimin kritik: si të rivlerësohen në mënyrë jetike idetë vetjake të një individi.</p>	<p>Punonjësit e deradikalizimit duhet të kenë njohuri fetare sepse ata duhet të fitojnë besimin e personit radikal të frymëzuar nga feja, qoftë si profesionist ashtu edhe si mësues.</p>
<p>Disa ekspertë kanë zbuluar se puna me emocionet pozitive ka qenë e suksesshme: emocionet e përdorura si terapi strategjike. Kjo funksionon sepse strategjitë emocionale ndihmojnë në rritjen e emocioneve pozitive të cilat ndihmojnë në krijimin e hapjes së nevojshme për një takim me këshilluesin (që përbën hapin e parë) dhe për të nisur një dialog dhe debat (të cilat janë hapat vijuese).</p> <p>Kjo funksionon veçanërisht me ata të rinj të cilët marrin terapi për shkak të këmbënguljes së prindërve të tyre – strategjia emocionale mund ta ndihmojë terapistin që të krijojë lidhjen e nevojshme për të vijuar me ndërhyrjen.</p>	<p>Strategjia emocionale gjithashtu mund të lehtësojë këshillimin fetar.</p> <p>Shumë të burgosur të dënuar për krime të lehta gjejnë një lloj qetësie kur rifitojnë vetëbesimin pasi largojnë urrejtjen e brendshme që kishin ushqyer më parë.</p>

Një praktikë e mirë konkrete (Torino, Itali).

Në burgun "Lorusso Cutugno" në Torino të Italisë, ndihma shpirtërore u është ofruar të burgosurve myslimanë që prej nëntorit të vitit 2016. Për të luftuar rrezikun e vetëcaktimit të imamëve në burg, në vitin 2015 u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi në nivel kombëtar ndërmjet Administratës së Burgjeve dhe UCOII, një organizatë italiane mëmë që përfaqëson organizatat më të vogla të besimit Islam. Kjo shoqatë identifikoi imamët të cilët mund të kualifikoheshin për të punuar në burgje: pas shtatë muajsh kontrollesh sigurie dhe administrative, tre imamët e parë u akredituan dhe filluan punën e tyre me të burgosurit islamistë. Projekti përfshin një shërbim këshillimi për familjen e të burgosurve.

Pjesëmarrja në projekt është mbi baza vullnetare: këshillimi fokusohet në vlerat e Islamit dhe të pajtimit, si dhe përdor argumentet që gjenden në Kuran. Imamët gjithashtu punojnë vullnetarisht dhe nuk janë të punësuar nga burgu, dhe as nga UCOII.

Fushat ku ende ka vend për përmirësime mbeten trajnimi i stafit, pengesat me gjuhën dhe mungesa e një vendi të dedikuar për shërbesat fetare.

Përfundime

Çfarë mungon ende që mund të ndihmonte me riintegrimin?

Rikthimi i të burgosurve në shoqëri është një sfidë: rikryerja e veprave, krizat emocionale dhe lejet e kufizuara të shërbimit të provës janë vetëm disa prej çështjeve që e bëjnë këtë gjë sfiduese. Ka disa histori individësh të cilët nuk kanë pasur mundësi reale pas lirimit të tyre nga burgu. Kjo ndonjëherë ndodh për shkak se individ ka qenë në burg për një kohë të gjatë apo për shkak të stigmatizimit që çon në izolim të mëtejshëm. Gjatë periudhës së riintegrit, individët në fjalë mund të kenë ndjesinë e vëzhgimit nga shoqëria. Sa i përket stigmatizimit, studimet duken se tregojnë që komunitetet në të cilat të burgosurit duhet të riintegrohen priren që t'i cilësojnë ndërhyrjet pa kontekst fetar me më tepër pozitivitet.

Fokusi duhet të jetë mbi të rinjtë, të cilët mund të ndikohen lehtësisht dhe, si rezultat, janë ata për të cilët ndryshimi është një opsion. Gjithashtu është e rëndësishme të kihet parasysh se zemërat e tyre do të qëndrojnë tek ata gjatë të gjithë jetës nëse nuk trajtohet përmes dialogut dhe këshillimit.

Ka vend për përmirësim të praktikave aktuale të cilat merren me tranzicionin nga burgu në shoqëri. Hendeqet dhe rekomandimet janë identifikuar në tabelën 2.

Hendeqet dhe rekomandimet për riintegrim të suksesshëm.

Hendeqet	Rekomandimet
Ngunjtësia e ndërhyrjeve	Këshillohet që të mendohet jashtë kornizave: cila ndërhyrje mund të përshtatet më së miri ndaj rrethanave të individit? Ka disa modele të ndryshme ndërhyrjesh që përfshijnë fenë (specifike sipas gjinisë, që përfshijnë besimin, ndër të tjera). Gjithashtu ka organizata të cilat nuk e identifikojnë veten e tyre si fetare, por që drejtojnë programe të cilat nxisin të menduarin kritik.
Mungesa e besimit dhe angazhimi	Përfshirja e personave të mëparshëm, të cilët kanë marrë dikur një rrugë të ngjashme ekstremiste të frymëzuar nga feja, mund të ndihmojë në mënyrën e ndërtimit të besimit. Gjithashtu, ato mund të ndihmojnë në përfshirjen e të burgosurit në grupe pro shoqërore dhe demokratike (angazhimi).
Kordinimi dhe mbështetja nga familja dhe xhamia	Kordinimi ndërmjet oficerëve të deradikalizmit/të burgut në njërin krah, si dhe xhamisë e familjes në krahun tjetër, është një praktikë efiçase. Kur personi rikthehet nga burgu, mënyra se si xhamia mund ta mbështesë të burgosurin dhe familjen e tij/saj duhet të planifikohet shumë përpara në kohë dhe në mënyrë të koordinuar.
Feja	Feja mund të ndihmojë me riintegrimin ashtu siç mund të përdoret në ndërhyrjet këshilluese dhe të deradikalizmit në burgje dhe shërbimin e provës. Udhëheqësi fetar jo vetëm i mundëson personit që të gjejë një shtëpi dhe një detyrë për ta ndjekur në shoqëri, por përmes ndihmës shpirtërore mund t'i japë edhe shpresë dhe objektiva shoqërore siç përshkruhen në mësimet fetare. Ky udhëheqës gjithashtu mund t'u mësojë individëve se si të pajtojnë fenë me shoqërinë. Pavarësisht se puna nis ndërkohë që personi është ende në burg, ajo është larg të konsideruarit si e përfunduar kur personi del nga burgu. Ndërhyrja është edhe më e rëndësishme veçanërisht në momentin që personi po përjeton sfidat e rikthimit në shoqëri.
Kombinimi udhëheqës-nxënës	Kur një nxënës i caktohet një udhëheqës, feja duhet të merret në konsideratë. Nuk ka një rregull, dhe fakti nëse duhet ti përkasin të njëjtës fe është e diskutueshme. Sa i përket një kombinimi mashkull-femër, ky vendim duhet të merret rast pas rasti.
Kundërshtitë dhe paragjykimet nga stafi	Stafi që punon në burgje, shërbimin e provës dhe ambiente komunitare duhet të jetë i trajnuar: me rritjen e njohurive mbi fenë Islame, zbehën paragjykimet.

SHTOJCA I - Programi spanjoll për radikalizmin e dhunshëm

Sistemi spanjoll i burgjeve nuk fokusohet te feja në programet e tij për radikalizmin e dhunshëm. Por kjo nuk do të thotë që shmanget feja. Përkundrazi, nevojat fetare të individëve pranohen plotësisht brenda programit. Gjithashtu, feja dhe ndërhyrja psikologjike cilësohen si në pajtim me njëra tjetrën. Programi ka për qëllim të ofrojë orientim të qartë, pa qenë shumë strikt: ai lejon fleksibilitet dhe rregullim sipas rasteve individuale.

Dy karakteristikat kryesore të programit janë:

1. Vullneti për të marrë pjesë, çka është një kërkesë ligjore;
2. Mundësia e përdorimit të ambienteve në grup së bashku me këshillimin individual.

Programi ka për qëllim të i) parandalojë rekrutimin e të burgosurve vulnerabël; ii) minimizojë rikryerjen e veprave dhe të maksimizojë riintegrimin; iii) parandalojë individët që të kryejnë vepra ekstremiste.

Programi ka tre grupe të synuara:

- a) Ata të dënuar për akte të lidhura me terrorin (ekstremizëm i theksuar, të veçuar nga pjesa tjetër e popullatës së burgut).
- b) Rekrutuesit: personat karizmatikë dhe inteligjentë, të cilët përhapin ide ekstremiste ndërmjet të burgosurve të tjerë. Ata priren të kenë një të kaluar kriminale.
- c) Të burgosurit vulnerabël: të rinjtë spanjollë të gjeneratës së dytë dhe të tretë, të konvertuar pa historik islamik dhe persona të tjerë përgjithësisht vulnerabël që mund të ndikohen lehtësisht nga ide ekstremiste.

Nisur nga kategorizimi i mësipërm, përfshirja e fesë në program varet kryesisht nga nevojat (fetare) individuale të të burgosurit. Megjithatë, për të garantuar një panoramë gjithëpërfshirëse, programi i kushton rëndësi edhe atyre të cilët qëndrojnë larg ekstremizmit.

Programi bazohet në parime të përbashkëta dhe të përshtatura sipas grupit të synuar. Parimet e përbashkëta:

- bashkëpunimi ndërmjet stafit i fokusuar në siguri dhe trajtim është thelbësor;
- rehabilitimi i personit duhet të jetë një përpjekje gjithëpërfshirëse në grup, me të gjitha elementet e programit të integruara me efikasitet dhe në përplotësim të njëra tjetrës;
- gjatë burgosjes lejohet mbështetje shpirtërore;
- mundësohet mësimi i gjuhës spanjolle; programet edukative ofrohen për të nxitur arritjet arsimore dhe për të përmirësuar integrimin kulturor të të burgosurve.

Për grupet e synuara nevojitet një ndërhyrje e individualizuar e cila ndërton një marrëdhënie besimi me të burgosurin. Kërkimi i individit për identitetin e tij është një komponent kyç brenda ndërhyrjeve për këtë grup të synuar, ashtu si edhe refuzimi kategorik i çdo bashkëpunimi me rrjetin kriminal. Për rekrutuesit dhe të burgosurit vulnerabël, ndërhyrjet mund të organizohen edhe në grupe të vogla, mbi bazën e qasjeve konjitive dhe të sjelljes të përshtatura sipas drejtuesve dhe ndjekësve.

Përmbajtja e programit është e ngjashme me tre grupet e synuara. Seancat organizohen si më poshtë:

Seanca	Përmbajtja
Rritja e ndërgjegjësimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërtimi i një marrëdhënie solide dhe besimi ndërmjet profesionistit dhe të burgosurit. ▪ Analiza e jetëve të të burgosurve dhe të nevojave të paplotësuara përmes një shkëmbimi të natyrshëm të informacionit. ▪ Ndërgjegjësimi emocional, i cili ndihmon në reduktimin e ndjenjave të brengës, frustrimit edhe të zemërimit. ▪ Kuptimi i çrregullimeve konjitive dhe i lidhjes ndërmjet sjelljes, emocioneve dhe mentalitetit. ▪ Identiteti personal dhe vetëdija mbi angazhimet deri në ditët e sotme. Pjesëmarrësit gjithashtu zhvillojnë ide mbi anëtarësinë e tyre në grupe të caktuara. ▪ Ndërgjegjësimi për besimet dhe nevojat personale, duke u fokusuar tek ato vlera që individët i konsiderojnë si të shenjta dhe të pandryshueshme.
Ndryshimi personal	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kuptimi i çrregullimeve konjitive dhe i lidhjes ndërmjet sjelljes, emocioneve dhe mentalitetit. ▪ Identiteti personal dhe vetëdija mbi angazhimet deri në ditët e sotme. Pjesëmarrësit gjithashtu zhvillojnë ide mbi anëtarësinë e tyre në grupe të caktuara. ▪ Ndërgjegjësimi për besimet dhe nevojat personale, duke u fokusuar tek ato vlera që konsiderohen si të shenjta dhe të pandryshueshme. ▪ Ndërgjegjësimi mbi sjelljen e dhunshme dhe diskutimi i arsyeve se përse pjesëmarrësit kanë mbështetur lëndimin e personave apo grupeve të tjera. ▪ Trajnim mbi vlerat sociale, respektimi i të drejtave të njeriut dhe i sundimit të ligjit në Spanjë. Mësimi i menaxhimit të konflikteve ndërpersonale. ▪ Ofrimi i ndihmës për të burgosurit që të marrin në konsideratë mënyrën e jetesës në mënyrë të atillë që u përshtatet nevojave të tyre duke mos e dëmtuar shoqërinë, larg nga dhuna dhe ekstremizmi.
Speciale (rekrutuesit dhe të burgosurit vulnerabël)	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërgjegjësimi mbi sjelljen e dhunshme dhe diskutimi i arsyeve se përse pjesëmarrësit kanë mbështetur lëndimin e personave apo grupeve të tjera. ▪ Trajnim mbi vlerat pro shoqërisë, respektimi i të drejtave të njeriut dhe i sundimit të ligjit në Spanjë. Mësimi i menaxhimit të konflikteve ndërpersonale. ▪ Ofrimi i ndihmës për të burgosurit që të marrin në konsideratë mënyrën e jetesës në mënyrë të atillë që u përshtatet nevojave të tyre duke mos e dëmtuar shoqërinë, larg nga dhuna dhe ekstremizmi.

Sa i përket vlerësimit, sistemi spanjoll parashikon një hap me tre faza. Aktualisht po punon për një “vlerësim specifik” që do të vendoset përpara zbatimit të programit (jo një instrument i vlerësimit të rrezikut). Për më tepër, mund të kryhet edhe një test psikologjik për të vlerësuar gjendjen mendore ose çdo prirje drejt dhunës ((për shembull, HCR-20 (Rreziku klinik historik)). E si përfundim, gjatë zbatimit të programit, duhet të ketë një shkëmbim të vazhdueshëm të informacionit ndërmjet të gjithë profesionistëve të përfshirë (nga çdo burg duhet të përgatitet dhe të dërgohet një raport të paktën çdo dy muaj).

Programi ekzistues ka përcaktuar edhe treguesit e arritjes, të cilët janë:

- ndihma, niveli i performancës dhe përpjekjet gjatë ndërhyrjes;
- distancimi gradual nga sjellja e dhunshme;
- shqyrtimi progresiv (jo i menjëhershëm) i besimeve ekstreme;
- ndryshimi në angazhime;
- përmirësimi i aftësive të empatisë dhe atyre pro shoqërore;
- kuptimi i shkaqeve që qëndrojnë në themel të ekstremizmit të dhunshëm;
- pranimi i faktit se aktivitetet e kaluara kanë qenë me natyrë kriminale;
- rakordim ndërmjet manifestimeve verbale (çfarë ata thonë) dhe sjelljes së përditshme.

Translated within:

